



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo




Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT

Nr. 02-060/01-0005630-3/26 dt. 10.02.2026

Mitrovicë



Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, alineja d, dhe nenit 43, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisje lokale (GZ Nr. 28, publikuar më 4 qershor 2008); dhe nenit 13, paragrafi 1, nënparagrafi 1.4, dhe nenit 52, paragrafi 2, të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e rregullt të mbajtur më dt. 10.02.2026, sjell këtë:

VENDIM

Për caktimin e orarit të mbajtjes së mbledhjeve të rregullta të Kuvendit të Komunës për vitin 2026

1. Mbledhjet e rregullta të Kuvendit të Komunës mbahen të mërkurën e javës së fundit të muajit, duke filluar nga ora 10:00.
2. Mbledhjet e rregullta të Komitetit për Politikë dhe Financa mbahen së paku dy (2) javë para mbledhjes së Kuvendit të Komunës, respektivisht ditën e mërkurë.
3. Kryesuesi i Kuvendit, në bashkëpunim me Kryetarin e Komunës, sipas nevojës mund të thërras mbledhje të rregullta edhe jashtë orarit të përcaktuar me pikën 1 të këtij vendimi.
4. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen Kryesuesi i Kuvendit dhe Kryetari i Komunës.
5. Vendimi shpallet tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale dhe hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës së Mitrovicës së Jugut.

Mitrovicë



Kryesuesi i Kuvendit

Safet KAMBERI

Dorëzohet:

1 x 1 Kryesuesit të Kuvendit

1 x 1 MAPL-së

1 x 1 Arkivit

Kopje: Kryetarit të Komunës